

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA
BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO

Sistemi i Pagesave në Kosovë

Prishtinë, 2003

Sistemi Ndërbankar i Pagesave

Sistemi i Kliringut Ndërbankar (SKN) ishte themeluar ne maj 2001 për të lehtësuar operacionet e pagesave vendore përmes sistemit bankar. ICS ka pësuar transformim të madh teknologjik dhe si rezultat i kësaj një transfer ndërbankar plotësisht elektronik ka filluar të aplikohet që nga prilli i vitit 2002. Suksesi i SKN pasqyron si rritjen dhe kthimin e besimit në sistemin bankar lokal.


BPK-ja jo vetëm që menaxhon dhe monitoron operacionet, por edhe merr pjesë direkt në sistemin e pagesave në të cilin janë pjesëmarrëse edhe shtatë bankat komerciale lokale. Sistemi i ri ofron mjete të përmirësuara të komunikimit ndërmjet bankave, përshtatje në kohë reale të bilanceve bankare të mbajtura në BPK, reduktim të ndjeshëm të rreziqeve dhe shpenzimeve për pagesat dhe shlyerjet dhe aftësinë për të ekzekutuar pagesat shpejt dhe me efikasitet. Standardizimi i numrave të llogarive bankare në bazë të IBAN u prezantua me sukses në të gjitha bankat në Kosovë.

Numri dhe vlera totale e transaksioneve të procesuara nga SKN-ja ka vazhduar të rritet në mënyrë të qëndrueshme. Deri në dhjetor të vitit 2002, mesatarja ditore transaksioneve bankë-bankë arriti në 640, krahasuar me rreth 40 transaksione në ditë në janar. Ndërsa shuma mesatare e transfertave të përpunuara nga ana e SKN-së ka mbetur pothuajse e pandryshuar, shuma mujore e përgjithshme e fondeve të transferuara ndërmjet bankave kishte kaluar nga 8.6 milion euro në 138.100.000 euro për të njëjtën periudhë.

Përveç pagesave normale (transfereve bankë-bankë) dhe atyre me prioritet (numer i vogël i transfereve individuale), SKN filloj të përfshijë edhe pagesat masive. Ka pasur një rritje të konsiderueshme në këtë lloj të transfertave si një rezultat i drejtpërdrejtë i të pagesave të pagave nëpërmjet llogarive bankare. BPK-ja vlerëson se ka rreth 200,000 të pagesave të tilla individuale të procesuara brenda një muaji.

Tarifat e ngarkuara nga SKN-ja, si për anëtarësim ashtu edhe për transaksionet, kanë mbetur te pandryshuara gjatë vitit. Një strukturë e re për tarifa, për të nxitur më tej një fleksibilitet më të madh në operacionet e pagesave, është duke u zhvilluar me bashkëpunimin e plotë të Ipac dhe pritet të futet në fillim të vitit 2003.

Sipas Rregullës XVII të BPK, të gjitha bankat e licencuara për të operuar brenda Kosovës duhet të mbajnë rezerva të likuiditetit në llogaritë në BPK. ICS departament ishte përgjegjës për monitorimin dhe administrimin e këtyre llogarive. ICS është përgjegjës edhe për funksionin e ndërlidhjes mes të BPK-së dhe bankave komerciale për operacionet ditore rreth llogarive të tyre të shlyerjeve .



Me gjithë progresin e konsiderueshëm të arritur në vitin 2002, SKN do të pësojë përmirësime të mëtejshme teknologjike dhe organizative. ICS do të vazhdojë të inkurajojë bankat komerciale për të zgjeruar infrastrukturën e tyre të komunikimit me rrjetin e tyre të degëve për të arritur një aftësi të plotë të shlyerjeve në kohë reale në sistemin bankar të Kosovës. Zgjerimi i lidhjeve ekzistuese të telekomunikacionit në mes të BPK-së dhe pjesëmarrësve tjerë SKN, siguria e këtyre linjave dhe mundësia e krijimit të një rrjeti pa tel do të hulumtohet në vitin 2003.